Pasqyrat Financiare DIGITALB sh.a.

per periudhen e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

Permbajtja

Pasqyra e pozicionit financiar	3
Pasqyra e te ardhurave gjitheperfshirese	4
Pasqyra e ndryshimeve te kapitalit	5
Pasqyra e flukseve monetare	6

DIGITALB sh.a.

Pasqyra e pozicionit financiar

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR INDIVIDUAL "DIGI-ALB" sh.a			
		Viti mbyllur me 31.12.2012	*Viti mbyllur me* 31.12.2011
AKTIVET	Ref.		
Aktivet afatgjata	5	**1,818,997,116**	**1,596,915,718**
Aktivet afatgjata materiale		927,704,240	994,908,574
Aktivet afatgjata jo materiale		796,211,143	516,876,046
Logari te arketueshme fianinciare		95,081,734	85,131,098
Aktivet afatshkurtra		**2,724,613,004**	**2,858,670,922**
Inventarë	6	205,464,497	290,167,678
Llogari te arketueshme tregetare	7	644,087,429	490,122,425
Llogari te arketueshme e te tjera	7	623,837,850	477,758,477
Mjetet monetare ne arke e ne banke	8	119,191,907	213,208,658
Parapagime dhe shpenzime te shtyra	9	1,132,031,320	1,387,413,685
Totali i aktiveve		**4,543,610,120**	**4,455,586,640**
KAPITALI DHE DETYRIMET			
Kapitali			
Kapitali aksionar	10	230,076,000	230,076,000
Sistemime ne llogarine e kapitalit		0	0
Rezerva te tjera		95,995,073	185,201,362
Rezerva ligjore		25,481,927	25,481,927
Fitime te mbartura			
Fitimi(humbje) e Ushtrimit		236,920,060	(89,206,289)
Interesat e pakicës ne Kapital		-	-
Totali i kapitalit		**588,473,060**	**351,553,000**
DETYRIMET		**1,927,271,000**	**1,661,469,587**
Detyrime afatgjata		-	-
Hua afatgjata		167,462,068	169,522,138.65
Tatimi i shtyre mbi fitimin	11		-
Grante,te ardhura te shtyra e te tjera detyrime		1,759,808,932	1,491,947,448.11
Detyrime te tjera afatgjata	12	-	-
			-
Detyrime afatshkurtra		**2,027,866,059**	**2,442,564,054**
Hua afatshkurtra		772,627,960	651,773,126.29
Llogari te pagueshme	13	1,116,779,802	1,695,136,717
Detyrime ndaj punonjesve	14	0	0
Detyrime Tatimore	15	113,974,844	82,277,277
Tatimi i shtyre	16	0	0
Llogari te pagueshme te tjera	17	24,483,454	13,376,934
Totali i detyrimeve		**3,955,137,060**	**4,104,033,641**
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		**4,543,610,120**	**4,455,586,640**

Keto pasqyra financiare dhe shenimet ne vijim nga faqja 7 deri ne 33, jane aprovuar nga drejtimi i Shoqerise me 28 Shkurt 2013 dhe jane nenshkruar ne emer te saj nga,

Z. Alban Jaho
Administrator i Pergjithshem

Znj. Teuta Vrushi
Drejtor i Departamentit te Finances

DIGITALB
info@digitalb.al, www.digitalb.al

Pasqyra e te ardhurave gjitheperfshirese

PASQYRA E ARDHURAVE SHPENZIMEVE GJITHEPERFSHIRESE "DIGIT-ALB" sh.a			
	Ref	*Viti mbyllur me 31.12.2012*	*Viti mbyllur me 31.12.2011*
Te ardhura nga shitja	16	4,054,538,984	4,288,676,761
Te ardhura te tjera jo operative		1,185,781,703	942,414,072
Materiale te para dhe te konsumueshme,mirmbajtje etj.	17	(567,826,920)	(683,831,932)
Shpenzime personeli	18	(173,658,213)	(142,801,181)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	19	(194,121,159)	(208,375,388)
Shpenzime te tjera	20	(3,952,669,800)	(4,225,257,801)
Fitimi operativ		**352,044,595**	**(29,175,469)**
Te ardhurat/shpenzime financiare nga njesite e kontrolluara(neto)			
Te Ardhura /Shpenzime financiare Neto	21	(55,710,984)	(37,187,439)
Total shpenzime financiare		**(55,710,984)**	**(37,187,439)**
Fitimi para tatimit		**296,333,611**	**(66,362,908)**
Efektet e tatimit te shtyre	23	-	
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	23	(59,413,550)	(22,843,381)
Fitimi i vitit		**236,920,060**	**(89,206,289)**
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse			-
Totali i te ardhurave te tjera gjithëpërfshirëse			
Fitimi qe i atribuohet aksionareve te kompanisë mëmë			-
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse qe i përket aksionareve te kompanisë mëmë	22	**236,920,060**	**(89,206,289)**

Keto pasqyra financiare dhe shenimet ne vijim nga faqja 7 deri ne 33, jane aprovuar nga drejtimi i Shoqerise me 28 Shkurt 2013 dhe jane nenshkruar ne emer te saj nga,

Z. Alban Jaho
Administrator i Pergjithshem

Znj. Teuta Vrushi
Drejtor i Departamentit te Finances

DIGITALB

Pasqyra e ndryshimeve te kapitalit

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL "DIGITALB" sha							
Per vitin financiar deri me 31 Dhjetor 2012							
							Ne Leke
	Kapitali aksionar	Primi i aksionit	Aksionet e thesarit	Rezerva statutore dhe ligjore	Fitimi i pashpernidare	Fitimi i ushtrimit	Totali
Pozicioni me 31 Dhjetor 2010	**230,076,000**	**-**	**-**	**25,481,927**	**67,301,561**	**147,899,803**	**470,759,291**
Efekti i ndryshimeve ne politikat kontabel							-
Pozicioni i rregulluar	**-**	**-**	**30,000,000**	**-**	**117,899,803**	**(147,899,803)**	**-**
Fitimi neto per periudhen kontabel	-	-				(89,206,289)	**(89,206,289)**
Dividendet e paguar			(30,000,000)				**(30,000,000)**
Rritje e rezerves se kapitalit							-
Emetimi i aksioneve							-
Pozicioni me 31 Dhjetor 2011	**230,076,000**	**-**	**-**	**25,481,927**	**185,201,364**	**(89,206,289)**	**351,553,002**
Efekti i ndryshimeve ne politikat kontabel							-
Pozicioni i rregulluar	**-**	**-**			**(89,206,289)**	**89,206,289**	**(0)**
Fitimi neto per periudhen kontabel						236,920,060	**236,920,060**
Dividendet e paguar							-
Emetim i kapitalit aksionar							-
Aksione te thesarit te riblera							-
Pozicioni me 31 Dhjetor 2012	**230,076,000**	**0**	**0**	**25,481,927**	**95,995,075**	**236,920,060**	**588,473,062**

Keto pasqyra financiare dhe shenimet ne vijim nga faqja 7 deri ne 33, jane aprovuar nga drejtimi i Shoqerise me 28 Shkurt 2013 dhe jane nenshkruar ne emer te saj nga,

Z. Alban Jaho
Administrator i Pergjithshem

Znj. Teuta Vrushi
Drejtor i Departamentit te Finances

www.digitalb.al

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare 31.12.2012

Pasqyra e flukseve monetare

PASQYRA FLUKSIT TE PARASE "DIGIT-ALB" sh.a		
	Viti mbyllur me 31.12.2012	*Viti mbyllur me* 31.12.2011
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit	**375,469,309**	**820,876,351**
Fitimi para tatimit	**296,333,611**	**(66,362,908)**
Rregullime për:		
Amortizimin i AAM	*194,121,159*	*208,375,388*
Efektet e tatimit te fitimit	**(59,413,550)**	*(22,843,381)*
Shpenzime per interesa	*51,223,432*	*69,460,530*
Levizjet ne Kapitali Qarkullues	**482,264,652**	**188,629,630**
Rritje(-)/rënie(+) në tepricën e kërkesave të arkëtueshme aktiviteti, si dhe kërkesave të arkëtueshme të tjera	(300,044,378)	*(104,829,031)*
Rritje/rënie në tepricën inventarit	84,703,181	*(47,156,156)*
Rritje/rënie në llogarite e furnitoreve	(578,356,915)	*673,283,784*
Rritje/rënie në llogarite te tjera te pagueshme	131,961,354	*218,678,188*
Rritje/rënie në marredheniet me buxhetin	31,697,567	*(2,208,518)*
Shpenzime te shtyra	255,382,365	*(32,460,632)*
Te ardhura te shtyra	267,861,484	*(73,060,915)*
Mjetet Monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit	**(106,795,343)**	**632,246,721**
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese	**(467,425,990)**	**(458,320,911)**
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(126,916,825)	(104,737,538)
Blerje e shoqerise se kontrolluar minus parate e aketuar	(289,285,732.67)	(284,122,842)
		-
Interesi i arkëtuar	(51,223,432.31)	(69,460,530)
Dividendët e arkëtuar	-	-
Mjete Monetare neto e përdorur në aktivitetet investuese	**(467,425,990)**	**(458,320,911)**
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare	**(2,060,071)**	**(248,062,417)**
Emetimi i kapitalit aksioner	-	-
Emetimi i aksioneve preferenciale	-	-
(Ripagim)/ te hyrat neto nga kreditë	(2,060,070.74)	(248,062,417.42)
Shtese te kapitalit aksioner		
Te tjera rivleresim kapitali	-	-
Dividendët e paguar	-	-
Mjete Monetare neto e përdorur në aktivitetet financiare	**(2,060,071)**	**(248,062,417)**
Rritja (+)/rënia(-) neto e mjeteve monetare	**(94,016,751)**	**39,188,697**
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	**213,208,661**	**174,019,964**
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël	**119,191,907**	**213,208,661**

Keto pasqyra financiare dhe shenimet ne vijim nga faqja 7 deri ne 33 ,jane aprovuar nga drejtimi i Shoqerise me 28 Shkurt 2013 dhe jane nenshkruar ne emer te saj nga,

Z. Alban Jaho
Administrator i Pergjithshem

Znj. Teuta Vrushi
Drejtor i Departamentit te Finances

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare 31.12.2012 (vazhdim)

1. Informacion i pergjithshem

Shoqëria"DIGITALB " sh.a ("Shoqeria") është krijuar juridikisht më 23.04.2004, regjistruar më 18.05.2004 ne QKR . Me 31 dhjetor 2012 pronësia e kapitalit zotërohet nga disa aksionerë. Kapitali është 230.076.000 lekë, i barabartë 1.800.000 euro i ndarë në 960.000 aksione. Shoqeria ushtron aktivitetin ne fushen e ndertim, tregetim, te sistemeve te telekomunikacioneve, prodhim te sherbimeve audio dhe video.

Zyrat qendrore te Shoqerise ndodhen ne Autostraden Tirane Durres Km 0 ,Kashar Tirane. NIPT i shoqerise eshte K 41719004 D. Nr.i Punonjesve 298 punonjes .

Shoqeria drejtohet nga Keshilli

Keshilli Mbikqyres perbehet:

1. Albert Sino
2. Petraq Shomo
3. Enkelejd Joti
4. Eduard Poda
5. Arben Taipi
6. Ilir Karaguni
7. Niko Leka

Veprimtaria e shoqerise drejtohet nga Administratori i saj Z.Alban Jaho .
Gjate periudhes 01.01.2012 deri me 31.12.2012 shoqeria ka kryer aktivitetin e saj ne perputhje me objektin e krijimit te saj.
Te dhenat krahasuese e periudhes ushtrimore paraardhese paraqesin informacionin financiar per periudhen 1 Janar – 31 Dhjetor 2012.

2. Politikat kontabel

Politikat kryesore kontabel te adoptuara per pregatitjen e ketyre pasqyrave financiare paraqiten si me poshte. Keto politika jane zbatuar ne menyre konsistente ne te gjithe vitet e paraqitura, perveç kur percaktohet ndryshe.

2.1 Bazat e pregatitjes

Pasqyrat financiare jane pregatitur ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF) te publikuara nga Bordi i Standarteve Nderkombetare te Kontabilitetit ("IASB") dhe interpretimeve te publikuara nga Komiteti i Interpretimeve te Raportimeve Financiare Nderkombetare ("IFRIC") te IASB.

Pasqyrat financiare jane pregatitur duke perdorur bazat e vleresimit te specifikuara nga SNRF per cdo tip te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes pershkruhen me ne detaj ne politikat kontabel me poshte.
Pregatitja e pasqyrave financiare ne perputhje me SNRF kerkon perdorimin e disa çmuarjeve kritike kontabel. Gjithashtu kjo kerkon qe drejtimi te perdore gjykimin e tij ne procesin e perdorimit te politikave kontabel te Shoqerise. Fushat qe perfshijne nje nivel te larte gjykimi apo kompleksiteti, ose fushat ku supozimet dhe çmuarjet jane te rendesishme per pasqyrat financiare paraqiten ne shenimin 3: Gjykime, çmuarje dhe supozime te rendesishme kontabel.
Pasqyrat financiare jane pregatitur per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012. Te dhenat krahasuese pasqyrojne gjendjen e pozicionit finaciar te shoqerise ne 31 Dhjetor 2012.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare 31.12.2012 (vazhdim)

Te dhenat aktuale ne keto pasqyra financiare jane te shprehura ne Leke.

2.2 Permbledhje e politikave te rendesishme kontabel

a) Monedhat e huaja

Monedha funksionale dhe e prezantimit
Zerat e perfshire ne pasqyrat financiare te Shoqerise maten duke perdorur monedhen e mjedisit kryesor ekonomik ne te cilin entiteti operon (monedha funksionale). Pasqyrat financiare jane paraqitur ne Leke, e cila eshte monedha e prezantimit te Shoqerise. Te gjitha veprimet ne monedha te huaja jane perkthyer me kursin e Bankes se shqiperise ne daten 31.12.2012 .

	31.12.2012	31.12.2011
Monedha	Kursi i kembimit	
EUR	139.59	138.93
USD	105.85	107.54
GBP	171.18	165.92
CHF	115.65	114.46

b) Njohja e te ardhurave

Te ardhurat njihen ne masen qe eshte e mundur qe perfitime ekonomike do te hyjne ne Shoqeri dhe qe te ardhurat mund te maten ne menyre te besueshme, pavaresisht se kur behet pagesa. E ardhura matet me vlere te drejte te shperblimit te mare per produktet dhe sherbimet e shitura , neto nga tatimi mbi vleren e shtuar dhe zbritje te mundshme te shitjeve. Kriteri specifik i njohjes i pershkruar me poshte duhet te arrihet para se te njihen si te ardhura.

Te ardhurat nga interesat
Interesat njihen ne proporcion me kohen qe reflekton te ardhuren efektive nga aktivi.

c) Tatimet

Tatimi mbi fitimin
Aktivi dhe detyrimet per tatimin mbi fitimin per periudhen aktuale maten me shumat e pritura per tu mare nga apo per tu paguar tek organet tatimore. Norma e tatimit dhe ligjet per tatimet te perdorura per llogaritjen e vleres se tatim fitimit, jane ato te nxjerra ose te publikuara ne daten e raportimit ne Shqiperi ku Shoqeria operon dhe siguron te ardhura te tatueshme.

Tatim mbi fitimin aktual qe lidhet me zera te njohur direkt ne kapital njihet ne kapital dhe jo ne pasqyren e te ardhurave.Drejtimi vlereson ne menyre periodike pozicionet e ndermarra ne formularet e deklarimit te pagesave ne lidhje me situata ne te cilat rregulloret e aplikueshme per tatimet jane subjekt i interpretimeve, si dhe njeh provizione nese eshte e pershtatshme.

Tatimi fitimi i shtyre
Tatimi mbi fitimin i shtyre sigurohet duke perdorur metoden e detyrimit mbi diferencat e perkohshme ndermjet bazes fiskale te aktiveve dhe detyrimeve dhe vlerave te mbartura te tyre per qellime te raportimit financiar ne daten e raportimit.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare 31.12.2012 (vazhdim)

Detyrimet per tatim fitimin e shtyre njihen per te gjitha diferencat e perkohshme te tatueshme, pervec:

- Kur detyrimi per tatim fitimin e shtyre lind nga njohja fillestare e emrit te mire ose nje aktiv apo detyrim nga nje transaksion qe nuk eshte kombinim biznesi dhe qe ne kohen e transaksionit, nuk ndikon as ne fitimin kontabel dhe as ne fitimin apo humbjen e tatueshme;

- Ne lidhje me diferencat e perkohshme te lidhura me investimet ne filiale, bashkepronesi dhe interesa ne sipermarrjet e perbashketa,kur koha e rikthimit te diferencave te perkohshme mund te kontrollohet dhe ka te ngjare qe diferencat e perkohshme nuk do te kthehen mbrapsht ne te ardhmen e parashikueshme.

- Tatim fitim i shtyre aktiv njihet per te gjitha diferencat e perkohshme te zbritshme, kreditet e tatimi fitimit te paperdorur te mbartur dhe humbjeve te tatueshme te pa perdorura. Tatim fitimi i shtyre aktiv njihet ne masen qe eshte e mundur qe do te kete fitim te tatueshem per kundrejt diferencave te perkohshme te zbritshme, dhe kreditet e tatimi fitimit te paperdorur te mbartur dhe humbjeve te tatueshme te pa perdorura mund te perdoren, perveç:

- Kur tatim fitimi i shtyre aktiv qe lidhet me diferenca te perkoheshme te zbritshme lind prej njohjes fillestare te nje aktivi apo detyrimi nga nje transaksion qe nuk eshte kombinim biznesi dhe qe ne kohen e transaksionit, nuk ndikon as fitimin kontabel dhe as fitimin apo humbjen e tatueshme;
- Ne lidhje me diferencat e perkohshme te zbritshme qe lidhen me investimet ne filiale, bashkepronesi dhe interesa ne sipermarrjet e perbashketa, tatim fitimi i shtyre aktiv njihet ne masen qe eshte e mundur qe diferencat e perkohshme do te rikthehen ne te ardhmen e afert dhe qe do te kete fitime te tatueshme perkundrejt te cilave mund te perdoren diferencat e perkohshme.

Vlera e mbartur e tatim fitimit te shtyre aktiv rishikohet ne çdo date raportimi dhe reduktohet ne masen qe nuk eshte me e mundur qe te kete fitim te tatueshem mjaftueshem qe te lejoje perdorimin e tatim fitimit te shtyre aktiv pjeserisht ose komplet.Tatim fitim i shtyre aktiv i panjohur rivleresohet cdo date raportimi dhe njihet ne masen qe eshte bere e mundur qe fitime te tatueshme te ardhshme do te mundesojne rimarrjen e tatim fitimit te shtyre aktiv.

Tatim fitimi i shtyre aktiv apo pasiv matet me normat tatimore qe pritet te perdoren ne vitin kur aktivi eshte realizuar ose detyrimi eshte paguar, bazuar ne normat tatimore (dhe ligjet tatimore) qe jane publikuar ose qe jane publikuar ne pjesen me te madhe te tyre ne daten e raportimit.

Tatim fitimi i shtyre qe lidhet me zerat te njohur jashte fitimit apo humbjes, njihen jashte fitimit apo humbjes. Zerat e tatim fitimit te shtyre njihen ose ne te ardhurat gjitheperfshirese ose direkt ne kapital ne menyre reciproke me transaksionin themelor.

Tatim fitimi i shtyre aktiv ose tatim fitimi i shtyre pasiv kompensohen nese ekziston nje e drejte ligjore e detyrueshme per te kompensuar tatim fitimin e shtyre aktiv aktual kundrejt tatim fitimit te shtyre pasiv aktual dhe qe tatim fitimi i shtyre lidhet me te njejtin entitet dhe te njejtin organ tatimor.

Perfitimet tatimore te siguruara si pjese e kombinimit te biznesit, por qe nuk plotesojne kushtin e njohjes se veçuar ne ate date, do te njihen me pas nese do te kete ndryshuar informacioni i ri ne lidhje me faktet dhe rrethanat. Rregullimi do te trajtohet ose si reduktim i emrit te mire sikur te ishte hasur gjate periudhes se matjes (persa kohe qe nuk e tejkalon emrin e mire) ose ne fitim ose humbje.

d) Aktive afatgjata materiale

Aktivet afagjata materiale paraqiten me kosto, duke i zbritur amortizimin e akumuluar dhe/ose nese ka humbje te renies se vleres. Te tilla kosto perfshijne kostot e zevendesimit te nje pjese te aktiveve afatgjata materiale dhe kostove te huase per projektet afatgjata nese plotesohen kriteret

e njohjes. Kur pjese te rendesishme te aktiveve afatgjata materiale nevojiten te zevendesohen ne intervale, Shoqeria i njeh keto pjese si aktive te vecanta me vlere te dobishme specifike dhe i zhvlereson ato ne perputhje me rrethanat.. Ne te njejten menyre, kur kryhet nje inspektim i madh, kosto e tij njihet ne vleren e mbartur te aktivit afatgjate material si nje zevendesim nese plotesohet kriteri i njohjes. Te gjitha riparimet e tjera dhe kostot e mirembajtjes njihen ne pasqyren e te ardhurave kur ndodhin.

Toka dhe ndertesat maten me vlere te drejte minus zhvleresimin e akumuluar te ndertesave dhe njohjes se humbjeve te renies se vleres pas dates se rivleresimit. Vleresimet jane kryer per te siguruar qe vlera e drejte e nje aktivi te rivleresuar nuk ndryshon materialisht nga vlera e mbartur e tij.

Cdo mbivlere rivleresimi njihet ne te ardhurat gjitheperfshirese dhe prej ketej kreditohet ne rezerven e rivleresimit te aktivit ne kapital, pervec rasteve kur ajo shfuqizon nje rivleresim ne renie te te njejtit aktiv te njohur me pare ne pasqyren e te ardhurave, duke u regjistruar keshtu ne pasqyren e te ardhurave e shpenzimeve. Nje rivleresim ne renie njihet ne pasqyren e te ardhurave, perveç kur kompenson nje mbivlere nga rivleresimi i te njejtit aktiv te njohur me pare ne rezerven e rivleresimit ne kapital.

Amortizimi llogaritet ne menyre lineare zbritese si me poshte:

Llojet e Aktiveve te Qendrueshme	Normat e aplikuara	Metoda e aplikuar
Ndertesa	**5%**	Me vlere te mbetur
Makineri dhe pajisje	**20%**	Me vlere te mbetur
Mjete transporti	**20%**	Me vlere te mbetur
Mobilje dhe Orendi	**20%**	Me vlere te mbetur
Te tjera	**20%**	Me vlere te mbetur
Pajisje Zyre dhe Informatike	**25%**	Me vlere te mbetur

Nje ze i aktiveve afatgjata materiale si dhe ndonje pjese e rendesishme e njohur fillimisht, ç'rregjistrohet me daljen jashte perdorimi te saj ose kur nuk pritet te sigurohen perfitime ekonomike te ardhshme nga perdorimi apo nxjerrja jashte perdorimit. Çdo fitim apo humbje qe realizohet nga dalja jashte perdorimit e aktivit (llogaritur si ndryshimi ndermjet te hyrat neto nga dalja jashte perdorimit dhe vlera e mbartur e aktivit) perfshihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur aktivi ç'rregjistrohet.

Vlerat e rikuperueshme te aktivit, jeta e dobishme dhe metodat e zhvleresimit rishikohen cdo fund viti financiar dhe rregullohen nese eshte e domosdoshme ne menyre prospektive.

e) Instrumentat financiare – njohja fillestare dhe matja ne vazhdim

i) Aktivet financiare

Njohja fillestare dhe matja

Aktivet financiare brenda objektit te SNK 39 klasifikohen si aktive financiare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes, huate dhe te arketueshmet, investime te mbajtura deri ne maturim, aktive financiare te disponueshme per shitje, ose si derivative te percaktuara si instrumenta mbrojtes ne nje mbrojtje efektive sic eshte e pershtatshme. Shoqeria percakton klasifikimin e aktiveve te saj financiare ne njohjen fillestare.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare 31.12.2012 (vazhdim)

Te gjitha aktivet financiare njihen fillimisht me vlere te drejte plus kostot e transaksionit, perveç rasteve te aktiveve financiare te rregjistruara me vlere te drejte permes fitimit e humbjes.

Blerjet ose shitjet e aktiveve financiare qe kerkojne dorezimin e aktivit gjate nje afati kohor te percaktuar nga rregullat ose konventat e tregjeve (rruga e drejte e te marredhenieve tregtare) njihen ne daten e transaksionit, p.sh., data kur Shoqeria merr persiper te blej apo shese aktivin.

Aktivet financiare te Shoqerise perfshijne mjetet monetare, llogarite e arketueshme dhe te tjera te arketueshme, huate dhe te tjera aktive.

Matja ne vazhdim e aktiveve financiare varet nga klasifikimi i tyre siç pershkruhet me poshte:

(a) Aktive financiare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes

Aktivet financiare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes perfshijne aktive financiare te mbajtura per tregtim te percaktuara ne njohjen fillestare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes. Aktivet financiare jane klasifikuar si te mbajtura per tregtim nese jane blere me qellimin per ti shitur ose riblere ne nje afat te shkurter kohor. Derivatet, duke perfshire ketu, derivativet e perfshire te veçuar, klasifikohen gjithashtu si te mbajtura per tregtim, perveç kur jane percaktuar si instrumenta te mbrojtjes efektive siç percaktohet nga SNK 39.

Aktivet financiare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes mbahen ne pasqyren e pozicionit financiar me vlere te drejte, me ndryshimet neto te njohura si kosto financiare ne pasqyren e te ardhurave.Aktivet financiare te percaktuara ne njohjen fillestare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes, percaktohen ne daten e njohjes fillestare dhe vetem nese permbushet kriteri i njohjes sipas SNK 39.
Shoqeria vlereson aktivet e mbajtura per tregtim, perveç derivativeve, per te percaktuar nese vendimi per ti shitur ne nje te ardhme te afert eshte akoma i vlefshem. Kur Shoqeria nuk eshte ne gjendje ti tregtoje keto aktive financiare per shkak te tregjeve joaktive dhe gjithashtu edhe vendimi i drejtimit per ti shitur ne te ardhmen e afert ndryshon rrenjesisht,

Shoqeria mund te zgjedhe ti riklasifikoje keto aktive financiare. Riklasifikimi ne hua dhe te arketueshme, te disponueshme per shitje apo te mbajtura deri ne maturim varet nga natyra e aktivit. Ky vleresim nuk ndikon ne asnje prej aktiveve financiare te percaktuara me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes duke perdorur ne daten fillestare opsionin e vleres se drejte, keto instrumente nuk mund te riklasifikohen pas njohjes fillestare.

(b) Huate dhe te arketueshmet

Huate dhe te arketueshmet jane aktive financiare jo-derivative me pagesa te percaktuara ose fikse dhe qe nuk jane te kuotuara ne nje treg aktiv. Pas matjes fillestare, te tilla aktive financiare maten ne vazhdim me kosto te amortizuar duke perdorur metoden e normes se interesit efektiv dhe duke zbritur renien e vleres. Kosto e amortizuar llogaritet duke mare parasysh çdo zbritje ose shtesa te blerjes dhe tarifat ose kostot qe jane pjese perberese e normes efektive te interesit. Amortizimi i normes efektive te interesit perfshihet ne te ardhurat financiare ne pasqyren e te ardhurave. Humbjet e njohura nga renia e vleres njihen ne pasqyren e te ardhurave si kosto
financiare per huate dhe ne kostot e shitjes ose ne shpenzimet e tjera operative per te arketueshmet.

C'rregjistrimi
Nje aktiv financiar (ose ku eshte e mundur pjese e aktivit financiar apo grup aktivesh financiare te ngjashme) ç'rregjistrohet kur:

- Te drejtat per te siguruar flukse monetare nga aktivi kane perfunduar
- Shoqeria ka transferuar te drejtat e saj per te siguruar flukse monetare nga aktivi ose ka supozuar nje detyrim per te paguar flukset monetare te mara ne teresi, pa vonesa materiale

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare 31.12.2012 (vazhdim)

nje pale te trete; dhe ose (a) Shoqeria ka transferuar ne menyre thelbesore te gjitha rreziqet dhe perfitimet e aktivit ose (b) Shoqeria as nuk ka transferuar dhe as ka mbajtur ne menyre thelbesore te gjitha rreziqet dhe perfitimet e aktivit, por ka transferuar kontrollin e aktivit.

Kur Shoqeria ka transferur ne menyre thelbesore te drejtat e saj per te siguruar flukse monetare nga nje aktiv; ajo vlereson nese dhe ne çfare mase ka mbajtur rreziqet dhe perfitimet e pronesise. Kur as nuk ka transferuar dhe as nuk ka mbajtur ne menyre thelbesore te gjitha rreziqet dhe perfitimet e aktivit, nuk ka transferuar as kontrollin e aktivit, aktivi do njihet ne masen e perfshirjes se vazhdueshme te Shoqerise ne aktiv. Ne kete rast, Shoqeria njeh gjithashtu nje detyrim te lidhur. Aktivi i transferuar dhe detyrimi i lidhur maten ne bazen qe reflekton te drejtat dhe detyrimet qe Shoqeria ka marre persiper.

Perfshirja e vazhdueshme qe merr formen e garancise mbi aktivin e transferuar matet me me te voglen ndermjet vleres origjinale te mbartur te aktivit dhe vleres maksimale te konsiderates qe Shoqeria mund te jete e detyruar te ripaguaje.

ii) Renia ne vlere e aktiveve financiare

Shoqeria vlereson ne çdo date te raportimit, nese ka evidence objektive qe nje aktiv financiar apo grup aktivesh ka pesuar renie vlere. Nje aktiv finanicar apo nje grup aktivesh financiare konsiderohet i zhvleresuar vetem nese ka evidence objektive per zhvleresimin si rezultat i nje ose me shume ngjarjeve qe kane ndodhur pas njohjes fillestare te nje aktivi (nje "ngjarje humbjeje" e ndodhur) dhe kjo ngjarje humbjeje ka pasur ndikim mbi flukset monetare te ardhshme te vleresuara te aktivit finanicar apo grupit te aktiveve financiare dhe qe mund te matet ne menyre te besueshme. Evidence e zhvleresimit mund te perfshije tregues qe debitoret apo grup debitoresh mund te jene duke perjetuar probleme te medha financiare, mospagesa ne kohe te principalit apo interesit, probabiliteti qe ata te kalojne ne falimentim ose nje riorganizim tjeter financiar dhe kur te dhenat e vezhgueshme tregojne se ka nje renie te matshme te flukseve monetare te ardhshme te parashikuara, te tilla si ndryshime ne fusha dhe kushtet ekonomike qe jane ne korrelacion me vonesat.

Aktivet financiare me kosto te amortizuar

Per aktivet financiare te mbajtura me kosto te amortizuar, Shoqeria fillimisht vlereson nese ka evidence objektive per zhvleresimin per aktivet financiare individualisht dhe qe jane ne menyre individuale te rendesishme, ose ne kolektiv per aktive financiare qe nuk jane individualisht te rendesishme. Nese Shoqeria percakton qe nuk ka evidence objektive per zhvleresimin per nje aktiv financiar te vleresuar individualisht, pavaresisht nese eshte i rendesishem apo jo, e perfshin aktivin ne nje grup aktivesh financiare me karakteristika rreziku krediti te ngjashem dhe i vlereson ne menyre kolektive per zhvleresim. Aktivet qe vlereson individualisht per zhvleresim dhe per te cilat ka ose do te kete nje humbje nga zhvleresimi, nuk do te perfshihen ne nje vleresim kolektiv zhvleresimi.

Nese ka evidence objektive qe nje humbje vlere ka ndodhur, shuma e humbjes matet si diference ndermjet vleres se mbartur te aktivit dhe vleres se skontuar te flukseve monetare te ardhshme te vleresuara (duke mos perfshire humbje te ardhshme krediti te cilat nuk kane ndodhur ende). Vlera e skontuar e flukseve monetare te ardhshme te vleresuara skontohet me normen origjinale te interesit efektiv te aktivit financiar. Nese nje kredi ka nje norme te ndryshueshme interesi, norma e skontimit per matjen e humbjes se zhvleresimit eshte norma e interesit efektiv aktuale.

Vlera e mbartur e nje aktivi zvogelohet gjate perdorimit te nje llogarie kompensimi dhe vlera e humbjes njihet ne pasqyren e te ardhurave. Te ardhurat nga interesi vazhdojne te perllogariten mbi vleren e reduktuar te mbartur dhe llogariten duke perdorur normen e interesit te perdorur per te skontuar flukset monetare te ardhshme me qellimin e matjes se humbjes nga zhvleresimi. E ardhura nga interesi rregjistrohet si pjese e te ardhurave financiare ne pasqyren e te ardhurave.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare 31.12.2012 (vazhdim)

Huate sebashku me kompensimin e lidhur me to ç'rregjistrohen kur nuk ka ndonje prospektive reale per rigjenerim ne te ardhmen dhe i gjithe kolaterali eshte perfituar ose i ka kaluar Shoqerise. Nese ne nje vit te mevonshem shuma e vleresuar e humbjes nga zhvleresimi rritet ose zvogelohet per shkak te nje ngjarjeje te ndodhur pas njohjes se zhvleresimit, humbja nga zhvleresimi i njohur me pare rritet ose pakesohet duke rregulluar llogarine kompensuese. Nese nje ç'rregjistrim rimerret ne nje moment te mevonshem, rimarrja kreditohet ne kostot financiare ne pasqyren e te ardhurave.

Investime financiare te disponueshme per shitje

Per aktivet financiare te disponueshme per shitje, Shoqeria vlereson ne çdo date raportimi nese ka evidence objektive qe nje investim apo grup investimi te jete zhvleresuar.

Ne rastet e investimeve ne letra me vlere kapitali te klasifikuara si te disponueshme per shitje, evidenca objektive do perfshinte nje renie te madhe dhe te tejzgjatur ne vleren e drejte te investimit nen koston e tij. 'Renia e madhe' vleresohet perkundrjet kostos origjinale te investimit dhe e tejzgjatur vleresohet kundrejt periudhes gjate se ciles vlera e drejte ka qene nen koston orgjinale te investimit. Kur ka evidence per renie te vleres, humbja e akumuluar – e matur si diference ndermjet kostos se blerjes dhe vleres se drejte aktuale, pakesuar me cdo humbje te renies se vleres se atij investimi qe me pare ishte njohur ne pasqyren e te ardhurave – ç'rregjistrohet nga te ardhurat gjitheperfshirese dhe njihet ne pasqyren e te ardhurave. Humbjet nga renia e vleres per investimet ne letrat me vlere te kapitalit nuk rimerren nepermjet pasqyres se te ardhurave; rritjet ne vleren e drejte pas zhvleresimit njihen drejteperdrejte ne te ardhurat gjitheperfshirese.

Ne rastin e instrumentave te borxhit te klasifikuara si te disponueshme per shitje, renia e vleres vleresohet bazuar ne te njejtin kriter si aktivet financiare me kosto te amortizuar. Megjithate shuma e rregjistruar per zhvleresimin eshte humbja e akumuluar e matur si diference ndermjet kostos se amortizuar dhe vleres se drejte aktuale pakesuar me cdo humbje te renies se vleres te atij investimi te njohur me pare ne pasqyren e te ardhurave.

Te ardhurat nga interesi vazhdojne te perllogariten mbi vleren e reduktuar te mbartuar te aktivit, duke perdorur normen e interesit te perdorur per te skontuar flukset monetare te ardhshme me qellim matjen e humbjes nga renia e vleres. Te ardhurat nga interesi rregjistrohen si te ardhura financiare. Nese ne nje vit te mevonshem, vlera e drejte e nje instrumenti borxhi rritet dhe kjo rritje mund te lidhet ne menyre objektive me nje ngjarje te ndodhur pas njohjes ne pasqyren e te ardhurave te humbjes nga renia e vleres, humbja nga renia e vleres rimerret nepermjet pasqyres se te ardhurave.

iii) Detyrimet financiare

Njohja fillestare dhe matja

Detyrimet financiare qe perfshihen ne qellimin e SNK 39 klasifikohen si detyrime financiare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes, hua dhe kredi, ose si derivative te percaktuar si instrumenta mbrojtes ne nje mbrojtje efektive, si eshte me e pershtatshme. Shoqeria percakton ne njohjen fillestare klasifikimin e detyrimeve financiare te saj.
Te gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlere te drejte, plus kostot direkte te transaksionit ne rastin e huave dhe kredive.

Detyrimet financiare te Shoqerise perfshijne llogarite e pagueshme dhe te tjera detyrime.

Matja e mevonshme

Matja e detyrimeve financiare varet nga klasifikimi i tyre siç pershkruhet me poshte:

Detyrime financiare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare 31.12.2012 (vazhdim)

